



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 577 Prot.

Tiranë, më 10/06 2014

Lënda : Dërgohet Rekomandimi, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Drejtuar : **Znj. Artemida ÇERCIZI**
Drejtore
Shkolla Speciale e Fëmijëve
Lgj. Nr 2, Rr.” Bahri Celmeta”, Durrës

Znj. Lindita MUKAJ
Drejtore
Drejtoria Arsimore Rajonale
Lagjja “28 Nëntori”, Durrës.

Bashkëlidhur ju dërgojmë Rekomandimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi çështjen “ex-officio” të Xheni Juba.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

R E K O M A N D I M

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në nenin 32, pika 1, germa c) të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, bazuar në informacionin e marrë nga gazetat e përditshme “Shqip”, ‘Panorama”, “Shekulli” dhe “Gazeta Shqiptare” të datës 13.10.2013, për situatën e dhunimit të shtetasës Xh. Juba, 17-vjeç me probleme shëndetësore, me urdhërin nr. 92, datë 29.10.2013 “*Për fillimin e procedurave për ndjekjen ex-officio të çështjes së nxënëses së Shkollës Speciale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar, Durrës*”, filloj procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Bazuar në informacionin e marrë nga gazetat e sipërcituara, nxënësja Xh. Juba, e cila ndjek procesin mësimor pranë Shkollës Speciale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar, Durrës, pretendohet të jetë dhunuar fizikisht. Lidhur me këtë ngjarje, shtypi pasqyron pretendimet si të Shkollës Speciale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara dhe të Qendrës Rezidenciale, banore e së cilës ishte nxënësja në fjalë.

Aftësia e kufizuar është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Përsa më sipër, për të verifikuar këtë ngjarje, bazuar shkresën me nr. prot 511/1 të datës 16.10.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi "Kërkesë për informacion", me qëllim informimin mbi situatën e paraqitur në media si dhe për të monitoruar zbatimin e ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri kontakttoi fillimisht me znj. Artemida Çerçizi, drejtoreshë e Shkollës Speciale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar, Durrës.

Në bisedën e bërë nga ana e përfaqësuesve të Zyrës së Komisionerit me znj. Çerçizi, (sikundër citohet edhe në proçes-verbalin e mbajtur gjatë takimit) u bë me dije nga kjo e fundit se nxënësja kishte vajtur në shkollë rrëth orës 8:40, ku ajo, si dhe nxënësit e tjerë që vijnë nga Qendra Rezidenciale, është pritur nga mësuesi që kishte mësim orën e parë dhe është vënë re nga ana e tij pasi ka hyrë në ambientet e shkollës që kishte një plagë në kokë. Kjo përfaktin se ajo kishte të vendosur në kokë një fjongo e cila nuk lejonte të dallohej menjëherë plaga. Eshtë dërguar (e shoqëruar edhe nga mësuesi) në spital për mjekim dhe në orën 10:10 është kthyer në Qendrën Rezidenciale.

Duke marrë shkas nga rasti konkret, Shkolla Speciale e Fëmijëve Durrës, proçesin e marrjes dhe dorëzimit të nxënësve nga Qendra Rezidenciale, e ka formalizuar duke mbajtur përfaktin proçes-verbal përkatës, ku dokumentohet kjo procedurë.

Nga informacioni i dhënë nga ana e drejtoreshës lidhur me regjistrimin e pranimin e këtyre nxënësve në shkollë, u mësua se ata bazohen vetëm tek diagnoza e përcaktuar në raportin e lëshuar nga Komisioni Mjekësor. Nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale Durrës, nuk është ngritur asnjë komision vlerësimi përfaktor këtë nxënës me aftësi të kufizuar.

Po kështu, ajo theksoi se:

- nuk ka një Komision të ngritur pranë shkollës apo pranë DAR, Durrës (Komision Multidisiplinar) që të vlerësojë nevojat arsimore dhe shoqërore te këtyre nxënësve me nevoja specifike.
- nuk punohet me programe specifike përfaktor këtë nxënës me aftësi të kufizuar (ku shumica e nxënësve janë me prapambetje të theksuar mendore- sikudër citon znj. Çerçizi), por vetë mësuesit nisur nga përvoja e tyre profesionale dhe dëshira e mirë përf t'i bërë sa më të asimilueshme nga nxënësit, kanë zgjedhur të punojnë me klasat e para, me Abetaret përf Kopështet.
- shkolla nuk ka psikolog, pasi me fondin e vet nuk ka mundësi ta sigurojë, dhe as nga ana e DAR, Durrës nuk i është bërë e mundur një gjë e tillë.
- nuk ka një rregullore të përcaktuar përf rregullimin e marrëdhënieve mes "Qendrës" dhe "Shkollës", sa i takon koordinimit të mbarëvajtjes së fëmijëve. Deri tanë gjithçka është realizuar falë bashkëpunimit dypalësh të përfaqësuesve të Qendrës dhe Shkollës, të cilët

kanë ruajtur kontakte të përditëshme telefonike, për të informuar reciprokisht njëri-tjetrin për securinë e sejcilit fëmijë. Kjo, është bërë e mundur përmes kontaktit me psikologen e Qendrës, të cilës i raportohet çdo ditë sjellja ditore e sejcilit nxënës të Qendrës.

- vetë Shkolla ka edhe "vajza kujdestare", të cilat shërbejnë si "asistente të mësuesve", për të ndihmuar sa më shumë këta të fundit. Ato kanë përfunduar shkollën dhe pavarësisht se mund të kenë dëmtime fizike trupore, mendërisht janë plotësisht të afta për t'u kujdesur për nxënësit e kësaj shkolle.

Bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson:

Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e "Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara", e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr. 108/2012, datë 15 Nëntor 2012, i cila i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuar, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Ajo ofron një mbrojtje të veçantë përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuar, për të siguruar që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si të gjithë fëmijët e tjera. Në interpretim të Konventës, personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

Ligji 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", në nenin 5, parashikon se: "Në Republikën e Shqipërisë garantonhet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsyet e tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar".

Referuar ligjit 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", në nenin 6, thuhet shprehimisht se: "...3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga cdo formë veprimi ose mosveprimi, që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral. 4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve. 5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim. 6. Nxënësve të familjeve në nevojë,

nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirsi në të nxënë, u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj... ”

Përsa i takon përcaktimit të institucionit arsimor ku duhet të arsimohet një fëmijë me nevoja të veçanta apo me aftësi të kufizuar, ka një kuadër nënligjor që garanton respektimin e të drejtave të fëmijëve për arsimim.

Referuar Dispozitave Normative për Arsimin parauniversitar 2013, është përcaktuar si detyrim i DAR/ZA-së ngritura e një: “*Komisioni multidisiplinar të përbërë nga një mjek pediatër (kur është e mundur, mjek pediatër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur një mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe drejtuesi i Njësisë së Shërbimit Psiko-Social*”. Ky komision vlerëson nevojat arsimore dhe shoqërore të fëmijës dhe ecurinë e tij, dhe vihet në lëvizje “*me kërkesën e prindit të fëmijës ose të drejtorit të institucionit arsimor, ku fëmija është regjistruar*”. Komisioni fton të paktën njërin nga prindërit gjatë vlerësimit të fëmijës, dhe po të jetë e nevojshme të afërm të tij. Kur fëmija është në kopësht/shkollë, përveç prindit marrin pjesë: punonjësi i shërbimit psiko-social në institucionin arsimor, mësues të fëmijës të caktuar nga drejtori i institucionit arsimor.

Ndërkohe që nuk ka një përfaqësim të fëmijëve të kësaj qendre në Bordin e prindërve të shkollës, gjë që do të ishte një mbështetje për trajtimin sa më dinjitoz të këtyre fëmijëve.

Sipas parashikimeve ligjore në Dispozitat Normative për sistemin arsimor parauniversitar 2013, në kreun XV për “Arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara”, përcaktohen qartë detyrimet e të gjitha strukturave për të garantuar të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar dhe pët të garantuar një arsim gjithëpërfshirës.

Nga sa rezultoi nga takimi me drejtoreshën e Shkollës Speciale të Fëmijëve, Durrës, me qëllim marrjen e informacionit lidhur me situatën e pretendimit të dhunimit të nxënësesh Xh.Juba, me probleme shëndetësore, si dhe monitorimin e zbatimit të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", procedurat e mësipërme nuk janë respektuar. Në fillim të vitit shkollor, DAR Durrës, nuk kishte krijuar një komision të posaçëm, dhe nxënësit pranoheshin në shkollë bazuar vetëm në raportin-mjekësor.

Nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 100, pika 2, të Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar 2013, (Shkollat e specializuara për nxënësit me aftësi të kufizuar) ku thuhet se:

“Shkollat e specializuara kanë punonjës të specializuar në aftësinë e kufizuar, që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara: mjekë, punonjës të shërbimit psiko-social, terapistë, si dhe mësues ndihmës”.

Gjithashtu nuk janë zbatuar as kërkesat e nenit 100, pika 3, të të Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar 2013, ku thuhet se:

“Nxënësit, që sipas gjykimit të komisionit të vlerësimit, kanë nevojë për trajtim të individualizuar, punojnë me PEI”.

Për këtë arsy, pavarësisht masave (nga ana e Drejtorese së Shkollës) për një trajtim sa më dinjitoz, me qëllim integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, nuk është arritur që këtyre nxënësve t'u ofrohet arsimim në përputhje me standartet që kërkojnë aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Referuar nenit 7, të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", sjellja diskriminuese mund të konsumohet si me veprim ashtu edhe me mosveprim.

Pika 1, e këtij nenit parashikon se: "*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një pesoni apo grupei personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngashme, në krahasim me persona ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.*"

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 32, gërmë "c", si dhe nenit 33, pikat 10 dhe 11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.201 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

R E K O M A N D O N :

- Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës duhet të marrë masa për të emëruar psikolog në Shkollës Specilale të Fëmijëve Durrës, sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara, për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës duhet të marrë masa për të bërë funksional Komisionin Multidisiplinar, sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara, për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.

- Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës në bashkëpunim me Drejtuesin e Shkollës Speciale të Fëmijëve Durrës, të marrin masa për hartimin e programeve të përshtatura (PEI -ve) për nxënësit me aftësi të kufizuar, sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara.
- Drejtuesi i Shkollës Speciale të Fëmijëve Durrës, të marrë masa për të ngritur Komisionin për nxënësit me aftësi të kufizuara, brenda shkollës, sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara, për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- Drejtuesi i Shkollës Speciale të Fëmijëve Durrës, të mundësojë parashikimin e një pike të veçantë në "Rregulloren e brendshme" të shkollës, ku të parashikohet e specifikuar mënyra e pritjes dhe përcjelljes së fmijëve nga mjediset e shkollës, si dhe rregullimi i marrëdhënieve me përfaqësuesit e tyre nga "Qendra Rezidenciale".
- Rekomandohet qe në Bordin e Prindërve të Shkollës Speciale të Fëmijëve Durrës, të bëjë pjesë një përfaqësues i Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, i cili të mbrojë interesat e fëmijëve që banojnë në këtë Qendër.

Konc.: R. Hoxha
 Pranoi.: V. Bushati
 Datë: 06.12.2013

